

KONTRATË PËR SHËRBIME

E lidhur në Lipjan më 24/05/2018, ndërmjet

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga z. Adem Duriqi , drejtorë i Drejtorisë së Prokurimit, në vazhdim (përmendet) Autoriteti kontraktues , në njëren anë;

N.SH. " A.M.C " lagja "Dardania" NR.1/5,1/6 1/7 zona I-Prishtinë që përfaqësohet nga Besfort Berisha pronar, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Dekorimi i sheshit "Adem Jashari" në Lipjan me flamuj shtetëror dhe dekorativ si dhe vendosja e tri binave me rastin e "Javës Kulturore 1, 12, dhe 14 qershor"

me numër Identifikues **613-18-3068-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Me datë 1 qershor (dita se fëmijëve) do të vendosen dhe largohen:**
bina me dimensione 6x4m (24m²) dhe lartësi 1m, duke përfshire edhe shkallet për hipje dhe zbritje nga bina, bina duhet te jete e shtruar me tepih si dhe prapa binës duhet te jene edhe shtyllat për vendosje te prapaskenave. Bina vendoset ne sheshin "Adem Jashari"

- shërbimi me zërim (10 mikrofona, 8 shpërndarës zëri me fuqi 5000w, kontraktuesi është i obliguar të të ketë llaptop me vete)

Me datë 12 qershor (ditës së çlirimit të Lipjanit) do te vendosen dhe largohen:

- bina me dimensione 6x4m(24m²),dhe lartësi 1m, e cila vendoset ne sheshin "Adem Jashari"
- flamujt kombëtar dhe shtetëror do te vendosen dhe zhvendosen ne shesh (te cilet i posedon komuna)
- shërbimi me zërim (10 mikrofona, 8shpërndarës zëri me fuqi 5000w, kontraktuesi është i obliguar të të ketë llaptop me vete.

Me rastin e 14 qershorit ku do të bëhet zbulimi i shtatores së Heroit të Kombit Ismet Asllani do te vendosen dhe largohen:

- bina me dimensione 4x4m(16m²),dhe lartësi 1m, e cila vendoset ne parkun e qytetit "Ismet Asllani".
- furnizmi me zërim (10 mikrofona, 8shpërndarës zëri me fuqi 5000w, dhe të ketë llaptop me vete)
- shërbimi me 150 karriga dmth kryesi i shërbimeve do të ofrojë 150 karrika për mysafirë për datë 14 Qershor të cilat pas përfundimit i merr me vete.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me me nënshkrim të kontratës nga te dy palët respektivisht 24 maj 2018 dhe përfundon me me kryerjen e shërbimeve respektivisht kthimin ne gjendje të më pashme në sheshi Adem Jashari dhe në parkun "Ismet Asllani" më së voni 16 qershor 2018.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhëreses nga Autoriteti kontraktues.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve Sheshi "Adem Jashari "dhe parku "Ismet Asllani" në Lipjan.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi i përgjithshëm i kontratës shprehur me numra :3960.00€;apo shprehur me fjalë,tremijë e nëntëqind e gjashtëdhjet Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e përgjithshme të pagesës pas pranimit të gjitha shërbimeve .për të cilën menaxheri i kontratës harton raport me shkrim.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatin e doganë

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përpunje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti shërbimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 kryesi i shërbimeve do të garantojë se do ti kryejë të gjitha shërbimet në afatin e paraparë dmth sipas kërkeses së Autoritetit kontraktues të përshkruara edhe në nenin 1 të kësaj kontrate

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, nuk është i obliguar që ta kryej asnjë pagesë edhe për shërbimet e pranuara.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë çfarëdo artikulli që përgatitet, për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të

nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik 1 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmon interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimi i nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.,

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqipnë tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

| | | | |
|-------------|------------------|-------------|-----------------------|
| Emri: | Besfaort Berisha | Emri: | Adem Duriqi |
| Pozita: | pronar | Pozita: | Drejtëor i prokurimit |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | 29.05.2018 | Data: | 29.05.2018 |
| Vula: | | Vula: | |



Sekcioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

| Nr. | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Çmimi | Totali |
|-------------|---|----------|-------|---------|---------|
| 1 | Dekorimi i sheshit "Adem Jashari", me flamuj dekorativ (vendosja dhe largimi i tyre, dekorimet i posedon DKRS-ja) | copë | 12 | 30.00 | 360.00 |
| 2 | Dekorimi i qytetit me flamuj kombëtar dhe shtetëror, (vendosja dhe largimi I tyre, dekorimet I posedon DKRS-ja) | copë | 100 | 3.00 | 300.00 |
| 3 | Shërbimi me 2 (dy) bina me dimensione 6mX4m , me lartësi prej 1m, duke përfshire edhe shkallet për hipje dhe zbritje, binat duhet te jete e shtruar me tepih, si dhe prapa binave duhet te jene edhe shtyllat për vendosjen e prapaskenave për datë 1 qershore 2018, me rastin e ditës së fëmijëve dhe tjetra me datë 12 qershor 2018, me rastin e ditës së Çlirimt, vendosja bëhet në sheshin Adem Jashari ne Lipjan, si dhe zhvendosja e po te njëjtave. | copë | 2 | 800.00 | 1600.00 |
| 4 | Shërbim me 1 (një) bine me dimensione 4mX4m , me lartësi prej 1m, duke përfshirë edhe shkallet për hipje dhe zbritje, bina duhet te jete e shtruar me tepih, si dhe prapa binave duhet te jete edhe shtyllat për vendosjen e prapaskenave për datë 14 qershor 2018, me rastin e ditës së dëshmoreve në parkun e qytetit Ismet Asllani me rastin e zbulimit të shtatores së Heroit të Kombit Ismet Asllani, më 14 qershor 2018 ne Lipjan. | cpa | 1 | 650.00 | 650.00 |
| 5 | Shërbim me karrike për datë: 14 Qershor 2018 me rastin e zbulimit të shtatores së heroit "Ismet Asllani" | cpa | 150 | 1.00 | 150.00 |
| 6 | Shërbim me zërim për data (01 Qershor 2018) tjetra (12 Qershor 2018) dhe (14.Qershor 2018), 10 mikrofona 8 shpërndarës zëri, fuqi 5000w si dhe llaptop te kete me vete. | komplekt | 3 | 300.00 | 900.00 |
| Gjithesejt: | | | | 3960.00 | |